

**28 gusht 2026,
Prishtinë**

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.01/ 2026-27 I KOMISIONIT TË GARAVE

I. Komisioni i Garave, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga personi i autorizuar i KB Fushë Kosova, zt. Bekim Dugolli, për t'u bërë anëtar i FBK-së, konstaton se plotësohen kushtet për regjistrim në përputhje me Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim në Federatën e Basketbollit të Kosovës.

II. Bazuar në Rregulloren për regjistrim dhe kalim në FBK 2026/2027, Komisioni i Garave merr vendim për regjistrimin e ekipit KB Fushë Kosova si anëtar të FBK-së.

III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit: 28.08.2026.

IV. Komisioni i Garave e përcjell aplikimin tek Bordi për miratim të përkohshëm.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me Vendimin Nr.01/2026-27, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

(a) Ekipi KB Fushë Kosova ka shprehur dëshirën për t'u bërë anëtar i Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe, në përputhje me nenin 4 të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim në FBK, ka paraqitur kërkesën për regjistrim tek Komisioni i Garave.


(b) Komisioni i Garave, në përputhje me nenin 5 nga Rregullorja për Regjistrim dhe Kalim në Federatën e Basketbollit të Kosovës, brenda afatit ligjor ka shqyrtuar kërkesën dhe ka marrë vendimin për regjistrimin e ekipit KB Fushë Kosova si anëtar të FBK-së.

(c) Pas shqyrtimit, Komisioni i Garave e përcjell këtë aplikim tek Bordi i FBK-së për miratim të përkohshëm, deri në pranimin përfundimtar të anëtarëve të rinj në Kuvendin e Federatës, në mbledhjen e radhës, me më shumë se 50% të votave të delegatëve të pranishëm.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës**KËSHILLË JURIDIKE:**

Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2026/2027, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.